

HAMIT KABA

**QËNDRIMI AMERIKAN NDAJ SHQIPËRISË
NË VITET E REZISTENCËS
(1943-1944)**

Gjykimi se Ballkani dhe Shqipëria si pjesë e tij gjatë LDB nuk përfaqësonin ndonjë rajon të veçantë për interesat amerikane, është tashmë një pohim i pranuar nga disa historianë¹. Por kjo është një e vërtetë relative, sepse interesi amerikan për Ballkanin gjatë LDB erdhi duke u rritur dhe në veçanti pas kapitullimit të Italisë në vjeshtë të vitit 1943. Një tjetër faktor që ndikoi ishte gjithashtu ishte rritja dhe zgjerimi i rezistencës në Shqipëri, në Greqi dhe në Jugosllavi, duke u bërë faktor me vlerë për vet këta popuj, por edhe për aleatët e mëdhenj. Megjithëkëtë, Ballkani ishte dhe mbeti një rajon jo primar për objektivat ushtarake dhe politike të Shteteve të Bashkuara të Amerikës gjatë LDB, pavarësisht nga dërgimi i Misioneve Ushtarake Amerikane, në Greqi, Jugosllavi dhe në Shqipëri në gjysmën e dytë të vitit 1943. Objektivat e këtyre misioneve dhe roli i tyre në mbështetje të lëvizjeve çlirimtare ishte jo aq i rëndësishëm sa ai i Misioneve Britanike.

Çekosllovakia dhe Shqipëria ishin dy vendet e para të Evropës, të cilat u pushtuan nga Gjermania dhe Italia dhe të parat që dhanë alarmin për rrezikun që i kanosej botës nga shtetet totalitare fashiste. Akti i pushtimit të Shqipërisë nga Italia e Musolinit, nuk u gjykua dhe vlerësua siç duhej, as nga fqinjët e saj, Greqia dhe Jugosllavia, por as edhe as nga Demokracitë e Mëdha Evropiane, si Britania e Madhe dhe Franca². “Qeveria britanike, jo vetëm që bëri sytë e verbër ndaj dhunimit flagrant të ligjit ndërkombëtar, por ajo gjithashtu u përpoq të zvogëlonte asgjësimin e pavarësisë së saj, në sytë e komunitetit britanik dhe atij ndërkombëtar”³. SHBA, ndonëse ruajtën neutralitetin deri më 7 dhjetor 1941, kohë kur u sulmua nga Japonia baza e tyre ushtarako-detare në Pearl Harbor, e dënuan sulmin italian mbi Shqipërinë. Përmes një deklarate të bërë

¹ Geir Lundestad, *The American Non-Policy Towards Eastern Europe, 1943-1947*, Tromsø u.a.: 1978, 96; Roderick Baily, “OSS-SOE Relations, Albania 1943-1944”, *Intelligence and National Security*, vol. 15, no. 2, Oxford: 2000, p.20.

² *Foreign Relations of United States (FRUS)*, Diplomatic Papers, 1939, Volume II, General The British Commonwealth and Europe, Washington: 1956, p. 378.

³ Bisser Petrov, “Great Britain and Resistance in Albania, 1943-1944”, *Etudes Balkaniques*, no. 2, Bulgaria: 2006, p. 88.

më 8 prill 1939, nga Sekretari i Shtetit, Cordel Hull, pushtimi i Shqipërisë nga Italia u konsiderua si një akt i dhunshëm dhe përdorim force, që kërcënonte paqen e botës⁴. SHBA ndërmorën edhe disa hapa të tjerë ndaj Italisë fashiste, duke i kërkuar Musolinit, që të tërhiqte trupat ushtarake nga Shqipëria. Por pas kërkesës së bërë nga qeveria kukull e Shqipërisë dhe nga diplomatët e Ministrisë së Jashtme të Italisë, për largimin e diplomatëve amerikanë nga Shqipëria, si rezultat i suprimimit të Ministrisë së Jashtme të Shqipërisë dhe kalimit të funksioneve të saj analoges italiane përfaqësia diplomatike e SHBA në Tiranë u mbyll më 16 shtator 1939. Po kështu u tërhoq edhe Faik Konica, përfaqësuesi i Shqipërisë nga Uashingtoni⁵. Me këtë akt ju dha fund marrëdhënieve diplomatike shqiptaro-amerikane, të cilat u rivendosën shumë vite më pas, më 15 mars 1991, pas rrëzimit të regjimit komunist në Shqipëri.

Gjer në vitin 1941, Ballkani përveç Shqipërisë në përgjithësi u shpëtoi efekteve direkte të Luftës së Dytë Botërore. Lufta italo-greke në dimrin e vitit 1940-1941, u zhvillua kryesisht përgjatë kufirit shqiptar dhe në territorin shqiptar. Megjithëkëtë, SHBA dënuan edhe sulmin italian mbi Greqinë dhe sulmin e Gjermanisë mbi Jugosllavinë, duke u dhënë popujve të tyre mbështetjen dhe premtimin për t'i ndihmuar⁶.

Pas vendosjes së ushtrive aleate anglo-amerikanë në Afrikën e Veriut në vitin 1942, zbarkimit në Sicili në qershor 1943 dhe avancimit të mëtejshëm të tyre në territorin e Italisë së Jugut, u rrit interesi i SHBA për Ballkanin dhe për Shqipërinë. Sidoqoftë duhet thënë se asnjëherë Ballkani nuk u bë objektivi më tërheqës për interesat amerikane. Ishte Evropa Qendrore, Pacifiku dhe tjera rajone, të cilat përbënin përparësi për amerikanët. Hap të rëndësishëm të politikës amerikane ndaj Shqipërisë përbën deklarata e Sekretarit të Shtetit, Cordel Hull, më 10 dhjetor 1942⁷. Përmes saj rikonfirmohej edhe njëherë qëndrimi i qeverisë së SHBA për mosnjohjen e pushtimit italian të vendit dhe dëshirën e saj për rimëkëmbjen e pavarësisë së Shqipërisë. Qëndrimi amerikan ndryshonte nga ai i Britanisë së Madhe, e cila ndonëse shprehej për pavarësinë e shtetit shqiptar, deklaronte nga ana tjetër se linte të hapur dhe të diskutueshëm problemin e kufijve të tij, në periudhën e pasluftës. SHBA përmes kësaj

⁴ *Peace and War: United States Foreign Policy, 1931-1941*, U.S.: "Department of State Publication", 1983, p. 454.

⁵ *FRUS*, Diplomatic Papers, 1939, Volume II, The British Commonwealth and Europe, Washington: 1956, pp. 416, 419, 420.

⁶ *Peace and War: United States ...*, pp.595, 639; President Roosevelt to King George of Greece, December 5, 1940; Statement by the Secretary of State on the Invasion of Yugoslavia, April 6, 1941.

⁷ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë* (më tej: AMPJ), viti 1944, dos. 17, fl. 15; Nicolas J. Costa, *Albania: A European Enigma, East European Monographs*, New York: "Columbia University Press", 1995, p. 113.

deklarate, do të vlerësonin edhe rezistencën e shqiptarëve, duke shfaqur dëshirën e popullit amerikan për ti ndihmuar ata ushtarakisht për të përzënë pushtuesin nga shtëpitë e tyre⁸.

SHBA dërguan misione ushtarake në Jugosllavi, Greqi dhe në Shqipëri, në verën dhe në vjeshtën e vitit 1943, të cilët kontribuan dhe ndihmuan në rritjen dhe fuqizimin e rezistencës së popujve të këtyre vendeve dhe në koordinimin e luftës së tyre me operacionet e aleatëve. Duhet të vëmë në dukje se rolin kryesor në Ballkan e kishte SOE britanike, për shkak të objektivave të saj politikë, të cilët ishin bërë prezent më herët në këtë rajon. OSS, si shkruan Kermi Roosevelt në parathënien e botimit: *The Secret War Report of the OSS*, ishte në shumë raste e huaj për mendimin dhe eksperiencën amerikane, madje edhe për instinktin amerikan. Por të kufizuara ishin edhe objektivat e saj, e cila duhej të zhvillonte propagandë, të mblidhte dhe analizonte informacionet, dhe në rast të caktuara do të zhvillonte një luftë jo ortodokse, e cila do të përfshinte edhe sabotimet, luftën psikologjike, luftën guerilje dhe mbështetjen e fshehtë të grupeve të rezistencës⁹.

Për arsye të ndryshme, për rolin e Misioneve Amerikane në Ballkan gjatë Luftës së Dytë Botërore, të cilat ishin në përbërje dhe varësi të Zyrës së Shërbimeve Strategjike (Office of Strategic Services-OSS), është shkruar pak¹⁰, dhe ca më pak për Shqipërinë. Vetëm këto tre vjetët e fundit janë shkruar dy libra, një nga Peter Lukas¹¹ dhe tjetri nga Agnes Jensen Mangerich.¹² Peter Lukas na njeh me veprimtarinë e anëtarëve të Misionit Amerikan në Shqipëri, me biografite dhe kontaktet e tyre me personalitete shqiptare të rëndësishëm të kohës. Ndërsa libri i dytë është shkruar nga një infermiere amerikane, e cila e kaloi një pjesë të dimrit të ashpër të vitit 1943-44 në Shqipëri, së bashku me një grup infermieresh dhe ushtarakësh amerikanë, aeroplani i të cilëve bëri ulje të detyruar, si rezultat i një aksidenti. Përmes librit të vet ajo na sjell të dhëna me interes, për trajtimin dhe mikpritjen që u ofroi atyre populli i thjeshtë dhe qëndresën e tyre në kushtet e vështira të shkatërrimeve të armikut dhe të dimrit të ashpër të viteve 1943-1944. Por burim bazë për shkrimin e këtij artikulli kanë qenë dokumentet e shumta arkivore të pabotuara, të gjetura në arkivat

⁸ *Po aty*.

⁹ Anthony Cave Brown, *The Secret War Report of the OSS*, New York: 1976, p.35.

¹⁰ Për veprimtarinë e OSS në Jugosllavi, me rëndësi paraqitet libri i amerikanit, Franklin Lindsay, *Beacons in the Night, With the OSS and Tito's Partizans in Wartime Yugoslavia*, Stanford, California: "Stanford University Press", 1993.

¹¹ Peter Lucas, *The OSS in World War II – Albania, Covert Operations and Collaboration with Communist Partisans*, North Carolina, USA: 2007.

¹² Agnes Jensen Mangerich, *Albanian Escape. The True Story of U.S. Army Nurses Behind Enemy Lines*, USA: 2006.

amerikane (fondi: Office of Strategic Services-OSS) dhe shqiptare dhe dokumentet amerikane të botuar (Foreign Relations of United States - FRUS), të cilat përmbajnë dëshmi të rëndësishme për politikën amerikane ndaj Shqipërisë dhe për veprimtarinë e misioneve ushtarake të saj, gjatë Luftës së Dytë Botërore në vendin tonë.

Kontributi i SHBA u materializua me dërgimin në Shqipëri të Misionit të vet Ushtarak në nëntor 1943, i cili krahas misioneve britanike, ndihmoi aktivisht luftën e popullit shqiptar kundër pushtuesit gjerman dhe në një farë shkalle, edhe afirmimin e saj ndërkombëtar. Regjimi komunist i vendosur në Shqipëri pas luftës nuk ishte i interesuar të vlerësonte dhe evidenconte rolin e misioneve amerikane gjatë LDB, për arsye tashmë të njohura. Në të kundërt, Enver Hoxha në kujtimet e tij¹³ (shih: Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë) e ka minimizuar, përgojuar dhe keqinterpretuar rolin e misionit ushtarak amerikan në Shqipëri dhe në veçanti drejtuesin kryesor të saj, oficerin amerikan me orgjinë shqiptare Tom Stefanin, i cili gjatë luftës ishte i atashuar pranë Shtabit të Përgjithshëm të UNÇL dhe vet Enver Hoxhës. Dokumentacioni i kohës tregon se bashkëjetesa ndërmjet Enver Hoxhës dhe Tom Stefanit ka qenë nga më normalet. Ndarja e pasluftës dhe mentaliteti i Luftës së Ftohtë, me sa duket kanë bërë punën e tyre edhe në këtë rast. Megjithëkëtë, në masën e thjeshtë të popullit dhe të një pjese të inteligjencies shqiptare u ruajtën konsiderata pozitive dhe mirënjohje për misionin amerikan në Shqipëri, për SHBA dhe ndihmën e dhënë prej, në një periudhë të vështirë për vendin. Për tu njohur me një histori tjetër, të painfektuar nga interpretimet e kohës së pasluftës, neve na vijmë në ndihmë sidomos dokumentet arkivore, të cilat na sjellin një histori “të arkivuar”, të ngjarjeve të shkuara, të cilat tashmë janë hapur pothuajse në mënyrë të plotë në Lindje, por edhe në Perëndim.

Misioni Amerikan në Shqipëri, 1943-1944

Misionet amerikane të OSS në Jugosllavi, Greqi dhe Shqipëri u mundësuan nga marrëveshjet e arritura ndërmjet drejtuesve të lartë të OSS dhe SOE britanike, në qershor 1942 dhe në gusht 1943¹⁴. Deri në vjeshtë 1943 rolin drejtues do ta kishte SOE britanike, ndërsa duke filluar nga tetori i vitit 1944, misionet amerikane të OSS do të ishin më të pavarura në aktivitetin e tyre. Ardhejes së misionit të parë amerikan në Shqipëri i parapriu një studim gati 200 faqe për Shqipërinë, i hartuar nga kapiteni David De-Bardleben- shef i Grupit Planifikues të OSS. Në dallim nga dy vendet fqinje, qeveritë në mërgim, të cilat

¹³ Enver Hoxha, *Rreziku Anglo-Amerikan për Shqipërinë*, kujtime, Tiranë: 1982, f.336-338.

¹⁴ *National Archives and Record Administration (NARA) of United States*, RG 226, Entry 99, Year 1943, pp. 1-23.

ishin të njohura nga të tre aleatët e mëdhenj, Shqipëria nuk kishte ndonjë qeveri të njohur prej tyre dhe më kryesorja nuk bënte pjesë në listën e vendeve që përfitonin nga programi “Lend Lease” i nënshkruar nga Presidenti Rusvelt, për të përfituar mbështetje dhe ndihma nga SHBA¹⁵. Shqipëria nuk konsiderohej gjithashtu një vend jetësor për interesat amerikane.¹⁶ Sidoqoftë kjo pengesë u kapërcye përmes argumentimit se qeveria amerikane nuk e kishte njohur pushtim italian të Shqipërisë, dhe se kjo e fundit kishte vlera të veçanta strategjike, duke u konsideruar si kyç i Adriatikut. Projekti i Shqipërisë u miratua nga gjenerali Donovan, drejtor i OSS. Programi i OSS për Shqipërinë parashikonte detyra të tilla si: ndërprerja e linjave gjermane të komunikimit, furnizimi i grupeve guerilje, goditjen e moralit të kuislingëve, shkatërrimi i depove të furnizimit të gjermanëve etj. Studimi përfshinte gjithashtu një material të rëndësishëm për grupet politike në vend. Sidoqoftë duke mos qenë në listën e “Lend Lease” Shqipëria nuk mund të përfitonte furnizime dhe armatime të rënda, si anije luftime, artileri etj.

Miratimi i planit për Shqipërinë ishte vetëm hapi i parë. Ai shënoi fillimin e përgatitjeve dhe të përpjekjeve të para për rekrutimin e personelit të OSS për Shqipërinë. Përpjekjet e para filluan në zyrën e OSS në Stamboll, por ato nuk dhanë rezultat, ndonëse me këtë detyrë u ngarkua Harry Fultz, një nga njohësit më të mirë të Shqipërisë dhe shqiptarëve. Më vonë u operua përmes zyrës së Kajros. Oficeri i OSS Dale McAdoo u ngarkua të merrej me rekrutimin e personelit të misionit të OSS për Shqipërinë. Ishte shpresuar që puna të ecte shpejt, por realiteti tregoi se përpjekjet për krijimin e ekipit të OSS për Shqipërinë kishin ngecur dhe puna ecte me hapat e kërmillit. “Shqiptarët, raportonte McAdoo, thjesht nuk besonin tek britanikët dhe e kishin të vështirë të kuptonin se pse Qeveria apo Komiteti Shqiptar i krijuar në mërgim, nuk njiheshin nga aleatët dhe pse ata nuk pranoheshin në Kombet e Bashkuara.¹⁷ Shqiptarët ndjeheshin të frikësuar nga rreziku i copëtimit të vendit nga Greqia, e sponsorizuar nga Britania e Madhe.

¹⁵ Wikipedia, <file:///E:/Lend-Lease.html> Lend Lease është emri i programit të miratuar nga Kongresi Amerikan më 11 mars 1941. Ky program i krijoi mundësinë Presidentit të SHBA që të ndihmonte vendet mike, që kontribuonin në luftën kundër fuqive të Boshtit, përmes shitjes, transferimit, këmbimit dhe dhënies me qira të ndihmave dhe furnizimeve ushtarake. Programi filloi të zbatohet 18 muaj pas shpërthimit të LDB. Në kuadër të këtij programi Kongresi miratoi shumë prej 50 miliard \$, që do t’u shkonin 38 vendeve të botës dhe Britanisë së Madhe, e cila përfitoi shumicën e tij (rreth 31 miliard \$).

¹⁶ Robert T. Brewer, “Albania: New Aspects, Old Documents”, *East European Quarterly*, 26, no.1 (March 1992), p.36.

¹⁷ *Po aty*, p. 40.

Anëtarët e parë të misionit të OSS për Shqipërinë, me emrin e koduar **“ERIK”**, zbritën në bregdetin shqiptar në Karaburun të Vlorës, më 17 nëntor 1944, dhe qëndruan në zonën e kontrolluar nga Balli Kombëtar për një periudhë gati 6 mujore. Në mars 1944 në Shqipëri do të vinte një mision tjetër amerikan, dhe kështu në mënyrë graduale do të shtohet më tej numri i amerikanëve të OSS në Shqipëri. Në 13 mars 1944 erdhi në Shqipëri edhe togeri dhe më pas kapiteni i ushtrisë amerikane, me orgjinë shqiptare Tomas Stefani, i cili në verë 1944, u atashua pranë Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Tomas Stefani qëndroi për një kohë të gjatë pranë Enver Hoxhës¹⁸. Misioni i dytë me emrin e koduar **“BESA”** u shpërnda pranë forcave ushtarake të Lëvizjes Nacionalçlirimtare, duke përfshirë edhe disa divizione dhe njësi partizane. Disa nga anëtarët e Misionit Amerikan të kohës së luftës, duke përfshirë edhe Tomas Stefanin, qëndruan në Shqipëri, deri më 29 shtator 1945 dhe në pragun e largimit nga Shqipëria disa prej tyre u dekoruan nga qeveria shqiptare¹⁹.

Misionet amerikane kontaktonin me zyrën e OSS në Bari, të kryesuar nga Harry Fultz. Ky i fundit komunikonte me përfaqësuesin politik të SHBA pranë Shtabit Aleat të Mesdheut, Robert Murphy dhe më pas me zëvendësuesin e tij, Alexander Kirk, ndërsa këta të fundit komunikonin me Zyrën e Uashingtonit për Shqipërinë, të kryesuar nga Earl Bernnan. Informacionet i përcilleshin Departamentit të Shtetit, Ministrisë së Luftës dhe në raste të caktuara edhe vet presidentit Rusvelt. Informacionet nga terreni përpunoheshin më tej nga Zyra e Kërkimit dhe e Analizës, e cila kishte në përbërje të vet studiues të talentuar. Cikli mbyllet me vendimet dhe direktivat e lëshuar nga Departamenti i Shtetit dhe Drejtori i Përgjithshëm i OSS, gjenerali Donovan. OSS nuk pati atë varësi nga Departamenti i Shtetit sikurse kishte analogja e saj britanike SOE nga Foreign Office. Sidoqoftë, njohja e dokumentacionit të OSS të çon në përfundimin se, pavarësisht se ajo ishte një organizëm informative-ushtarake, politikën e madhe e përcaktonte DSH dhe Presidenti.

Misioni i OSS në Shqipëri, në mbarim të luftës u tkurr numerikisht, dhe në Shqipëri mbeti vetëm një pjesë e tij, e cila u mor kryesisht me dërgim informacionesh të ndryshme nga Shqipëria. Ndër aksionet e para të Misionit

¹⁸ Enver Hoxha në librin e tij “Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë” shkruan me përçmim për Tomas Stefanin, ndërkohë që në kohën e luftës pati me të marrëdhënie më të mira se me çdo oficer tjetër aleat anglo-amerikan.

¹⁹ *Bashkimi*, 29 shtator 1945. Në ceremoninë e organizuar në Hotel Dajti, për nder të Misionin Ushtarak Amerikan që po largohej nga Shqipëria, u dekoruan disa nga anëtarët e tij si: kapiten Thomas Stefan, toger John O’Keefi, toger Nick Kooky dhe kaporal Geroge Routis. Ndër të larguarit e fundit ishte edhe ish profesori i Normales së Elbasanit, Stefan Peters, i cili në periudhën e pasluftës punoi në Departamentin e Shtetit, dhe përgatiti disa studime të rëndësishme për Shqipërinë. OSS u likuidua në tetor 1945 dhe vendin e saj do ta zinte në vitin 1947, CIA- Central Intelligence Agency.

Amerikan në Shqipëri, ishte ai i gjetjes dhe kthimit në Itali, të një ekipi të një aeroplani amerikan pre 30 personash, ndër të cilët 14 infermiere, i cili bëri ulje të detyruar në afërsi të Beratit në nëntor 1943. Për këtë qëllim, OSS ngarkoi kapitenin Lloyd Smith, i cili, në bashkëpunim me Misionin Amerikan dhe atë britanik mundësoi kthimin e tyre në Itali brenda një periudhe dy mujore²⁰.

Deklarata amerikane e dhjetorit 1942 do të pasohej nga vlerësime të tjera më të shpeshtuara në vitin 1944, përmes të cilave vlerësohej rezistenca e popullit shqiptar dhe njohja e pavarësisë së tij. Të tilla deklarata u bënë më 7 prill²¹, më 2 qershor dhe më 28 nëntor 1944 etj. Madje më 1 janar 1944, një vlerësim për rezistencën e shqiptarëve dhe rikthimin e pavarësisë së Shqipërisë, erdhi nga senatori i Floridas dhe anëtari i Komitetit për Punët e Jashtme në Senatit Amerikan, Cloude Pepper²², i cili në korrik 1946, paraqiti në Senatit Amerikan një rezolutë, për ndryshimin e kufijve të Shqipërisë në favor të Greqisë, e cila u miratua unanimisht.

Dokumentet e nxjerra nga arkivat amerikane dhe më pak ato shqiptare, sjellin vlerësime të rëndësishme për shkallën e rezistencës shqiptare në përgjithësi, e krahasuar kjo me analoget e saj në Greqi dhe në Jugosllavi; me shkallën e impenjimit dhe angazhimit konkret të forcave të ndryshme politike dhe ushtarake në Shqipëri; me qëndrimin nga njëra anë të Departamentit të Shtetit dhe të Presidentit ndaj qeverisë së Zogut në emigracion, dhe nga ana tjetër edhe ndaj qeverisë së FNÇL, të dalë nga Kongresi i Përmetit, apo mbledhja e Beratit; për rolin e individëve të njohur të Shqipërisë në LDB; për konfliktin civil në Shqipëri, për motivet dhe arsyet e forcave që u konfrontuan; për prirjen komuniste të udhëheqjes së LNÇ; për konceptet dhe qëndrimet ndaj problemit të Kosovës, vlerësime për shkallën e angazhimit në luftë të forcave ushtarake dhe politike në Shqipëri etj. Dokumentet amerikane, të ndërthurura me ato shqiptare dhe britanike, na krijojnë mundësinë të krijojmë ide të qarta, të asaj se çfarë ndodhi në të vërtetë në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore²³.

²⁰ NARA, RG 226, Entry 154, Raport i kapitenit Smith për kolonelin West, 9 janar 1944; A. Mangerich, *vep. e përm.*

²¹ AMPJ, viti 1944, dos. 16, fl. 2.

²² *Po aty*, fl. 1.

²³ Librat me kujtime, të shkruar nga anëtarë të Misioneve Britanike në Shqipëri gjatë LDB, të cilat pothuajse janë përkthyer në gjuhën shqipe, duke përfshirë këtu edhe librin e amerikanit Peter Lukas, kanë vlera jo të pakta. Por në kushtet e sotme, kur në SHBA dhe në Britaninë e Madhe, por edhe në Shqipëri janë hapur arkivat, jo vetëm diplomatike por edhe ushtarake, mendoj se informacioni i këtyre të fundit, është më i rëndësishëm, sepse ato janë burime të dorës së parë, të shkruara në kohën kur kanë ndodhur ngjarjet. Po kështu ato janë “të pastra” nga interpretimet dhe mbishtresat e mëvonshme, të cilat mbartin mentalitetin e Luftës së Ftohtë. Këto konsiderata ca më shumë janë të vlefshme, kur studiojmë kujtimet e Enver Hoxhës, të shkruara shumë vonë pas ngjarjeve dhe të dëshmuara vetëm prej tij.

Dokumentacioni shqiptar nga ana e vet, të krijon ide të qarta për sjelljen e forcave politike dhe ushtarake në Shqipëri ndaj aleatëve të mëdhenj; perceptimin e ndonjë zbarkimi të mundshëm të aleatëve anglo-amerikanë në Ballkan dhe në Shqipëri; gjykimet dhe vlerësime për ndihmën e dhënë nga aleatët gjatë LDB; frikën permanente të dy palëve nacionalistëve dhe komunistëve, se Britanisë së Madhe do të mbështeste pretendimet greke ndaj Shqipërisë pas luftës; kërkesat e tyre të vazhdueshme për të njohur Shqipërinë si vend aleat dhe për ta afruar atë me Organizatën e Kombeve të Bashkuara në krijim e sipër; etj.

Shqipëria: një aleat i harruar

Në pamundësi trajtimi të të gjithë problemeve të përmendura më lart, do të përqendrohëm tek dy çështje: **së pari**, cili qe qëndrimi i qeverisë amerikane ndaj statusit të Shqipërisë gjatë LDB? A u konsiderua ajo juridikisht një komb aleat i shoqëruar, apo thjesht u njoh rezistenca shqiptare? **Së dyti**, çfarë qëndrimi mbajti qeveria amerikane ndaj qeverisë së Zogut në mërgim, dhe po kështu ndaj qeverive të FNÇL, të dala nga Kongresi i Përmetit dhe Mbledhja e Beratit e tetorit 1944?

Gjatë LDB, por edhe pas saj, tek shqiptarët në përgjithësi por edhe tek studiuesit, qofshin këta brenda apo jashtë vendit, ka mbizotëruar ideja se Shqipëria ka qenë në realitet një vend aleat gjatë LDB, pavarësisht se ajo nuk kishte firmosur ndonjë dokument për përfshirjen e saj në radhët e Kombeve të Bashkuara dhe nuk kishte ndonjë qeveri të njohur nga Aleatët e Mëdhenj. Ky opinion është formuar duke u bazuar në luftën e përbashkët që ka bërë populli shqiptar kundër pushtuesve italianë dhe gjermanë, në vlerësimet e vazhdueshme të Aleatëve të Mëdhenj, në vetë prezencën dhe ndihmën e dhënë nga misionet anglo-amerikane në Shqipëri gjatë LDB. Për këtë çështje forcat kryesore politike dhe ushtarake në vend, pavarësisht nëse ato i përkisnin Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar, organizatës së Legalitetit, apo të Ballit Kombëtar kanë pasur një mendim unik. Të gjitha e konsideronin vendin e tyre pjesë të padiskutueshme të familjes së kombeve aleate²⁴, duke kërkuar të bëheshin anëtare të Kombeve të Bashkuara që gjatë LDB. Në promemorien që Mit'hat Frashëri i dërgonte Misionit Amerikan të OSS në Shqipëri më 15 korrik 1944, në emër të Komitetit Qendror të Ballit Kombëtar thuhej: "Shqipëria nuk është njohur zyrtarisht si anëtare e Kombeve të Bashkuara, ndonëse në realitet ajo është një vend aleat, ashtu si dëshmohet nga rezistenca dhe lufta e saj kundër okupatorit. Njohja zyrtare do ta vendoste Shqipërinë në një pozitë më të sigurt

²⁴ NARA, RG 226, Entry 154, 18 maj 1944, Promemorje e Lëvizjes së Legalitetit për Qeverinë e Britanisë së Madhe dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës mbi Shqipërinë, f. 4.

dhe të pa rrezikuar në të ardhmen, dhe do të bënte të mundshme që, populli shqiptar të mos kursente asgjë, me qëllim që të jepte kontributin e tij modest për kauzën e përbashkët”.²⁵ Gjatë LDB Shqipërisë nuk ju njoh nga Aleatët e Mëdhenj statusi i një “kombi aleat”, “aleat i shoqëruar” apo ndryshe “fuqi shoqe,” sikurse shumica e vendeve që kishin qenë anëtarë të Lidhjes së Kombeve. Shqipëria u njoh si “fuqi shoqe”, gjatë zhvillimit të punimeve të Konferencën e Paqes së Parisit, të vitit 1946. Pavarësisht nga konsideratat juridike të fuqive aleate, qeveria shqiptare u ftua të merrte pjesë, ndonëse me vonesë edhe në Konferencën e Parisit të Reparacioneve me Gjermaninë, në nëntor – dhjetor 1945. Pjesëmarrja e Shqipërisë në dy konferencat e mbajtura në Paris, në vitin 1945 dhe 1946, pa pasur statusin e një kombi aleat ose aleat i shoqëruar, do të thoshte në realitet të pranoje se Shqipëria ishte shtet jo i mundur. Megjithëkëtë, mungesa e statusit të njohur u shfrytëzua nga qeveria greke, për ta konsideruar Shqipërinë një shtet të mundur, i cili duhet tu nënshtrohej rregullave të një shteti humbës. Fakti që Shqipëria përfitoi dëmshpërblime nga dy shtetet humbëse, Gjermania dhe Italia, dëshmon se ajo gjatë LDB, nuk ishte shtet humbës, por juridikisht as fitues. Këtë realitet e pohon edhe historiani amerikan me orgjinë shqiptare Nikola Kosta, i cili shprehet: “Shqipërisë nuk ju garantua kurrë statusi i një aleati ose aleati të shoqëruar”.²⁶ Pavarësisht nga perceptimi i shqiptarëve se lufta e tyre ishte pjesë e rezistencës së madhe të kombeve aleate kundër fuqive të Boshtit, duhet të pranohet se vendi ynë nuk e siguroi dot gjatë LDB statusin e lartpërmendur.

Aleatët gjatë LDB nuk njohën as qeverinë e Zogut në emigracion dhe as qeveritë e FNÇL, të dala nga Kongresi i Përmetit dhe Mbledhja e Beratit. Si rezultat, Shqipëria as nuk u ftua të merrte pjesë në evenimentet e mëdha të LDB. Shqipëria nuk mundi të firmoste Deklaratën e Kombeve të Bashkuara as më 1 janarit 1942, sikurse bënë 27 shtete të botës, dhe as më vonë kur me të u bashkuan edhe 19 shtete të tjera. Shqipëria nuk mundi ti shpallte “luftë Gjermanisë” brenda 1 marsit 1945, sikurse bënë disa shtete të tjera sidomos nga Amerika Latine. Shqipëria, ndonëse kishte qenë një ndër 45 shtete anëtarë të Lidhjes së Kombeve, as që u parashikua që ajo të merrte pjesë në mbledhjen themeluese të Kombeve të Bashkuara, që do të mbahej në mars 1945 në San Francisko. Në konferencën e Dumbarton Oaks (21 gusht-7 tetor 1944), e cila përgatiti hapat e fundit për themelimin e Kombeve të Bashkuara, u diskutua edhe për anëtarët e saj dhe kushtet që ata duhej të përmbushnin për të asistuar në mbledhjen themeluese, që do të mbahej në San Francisko. Për këtë qëllim, më 7 tetor 1944 u mbajt një takim i posaçëm i Grupit të Përbashkët të Formulimit, që përfaqësonte SHBA, Kinën dhe Britaninë e Madhe, për të

²⁵ *Po aty*, RG 226, Entry 154, Promemorje e Mit’hat Frashërit në emër të Komitetit Qendror të Ballit Kombëtar drejtuar Fultz, më 1 korrik 1944.

²⁶ Nicolas J. Costa, *vep. e përm.*, p. 113.

diskutuar rreth anëtarëve që do të merrnin pjesë në Kombet e Bashkuara. Grupi i të tretëve pranoi se në Kombet e Bashkuara nuk do të hynin të gjitha vendet që kishin qenë anëtarë të Lidhjes së Kombeve. Nga 45 ish-anëtarë të LK, do të ftoheshin vetëm 29 prej tyre. Ndërmjet 9 shteteve që nuk do të pranoheshin në KB ishte edhe Shqipëria, e cila nuk konsiderohej as pjesë e Kombeve të Bashkuara, dhe as si komb i shoqëruar²⁷. Shqipëria u përfshi në një grup me Afganistanin, Argjentinën, Danimarkën, Portugalinë, Suedinë, Zvicrën dhe Turqinë. Por, në mbledhjen themeluese të Kombeve të Bashkuara në San Francisko, 3 nga vendet e lartpërmendura (Argjentina, Danimarka dhe Turqia, morën pjesë në të²⁸. Duket se Shqipëria nuk plotësoi një nga kushtet themelore të pranimit, atë të shpalljes luftë Gjermanisë, deri më 1 mars 1945. Mosplotësimi i kuadrit juridik, por edhe të tjerë faktorë, duket se kanë ndikuar në mos thirrjen e përfaqësuesve të Shqipërisë në Konferencën e San Franciskos. Mosnjohja e një qeverie të njohur nga Aleatët e Mëdhenj, interesat periferike të tyre ndaj Shqipërisë dhe çështjes shqiptare, interesat më të mëdha ndaj fqinjëve grek dhe jugosllavë, mungesa e kohezionit të forcave të brendshme në vend, dhe në përgjithësi imazhi i dobët ndërkombëtar i Shqipërisë, mund të jenë disa nga faktorët shpjegues të këtij qëndrimi.

Së dyti, cili ishte qëndrimi zyrtar i qeverisë amerikane ndaj qeverisë së Zogut në emigracion? Aleatët e Mëdhenj dhe qeveritë e tyre (SHBA, Britania e Madhe dhe Bashkimi Sovjetik) nuk e njohën qeverinë e Zogut në emigracion, as në periudhën e hershme të largimit të tij nga Shqipëria, por edhe më vonë, pavarësisht nga kërkesat për njohjen saj, të ardhura nga qeveria në emigracion, nga organizatat e shqiptarëve në SHBA, nga mërgimtarë të shquar shqiptarë, me status politik apo kishtar siç ishte edhe Fan Noli, për një periudhë kohe nga Mehmet Konica etj²⁹. Kërkesa për njohjen e saj dhe përfshirjen e Shqipërisë në Kombet e Bashkuara kanë dalë edhe nga brenda Shqipërisë. Kërkesat e paraqitura nga shqiptarët dhe interesi i qeverisë amerikane për zhvillimet shqiptare sidomos në vitin 1944, zgjuan interesin e presidentit Rusvelt, i cili më 26 maj 1944, i kërkoi Ndihmës Sekretarit të Shtetit, Dean G. Achensohn sqarime se, pse Shqipëria nuk ishte ftuar të merrte pjesë në Konferencën për Ushqimin dhe Bujqësinë të Kombeve të Bashkuara, të mbajtur në Hot Springs të Virxhinias në vitin 1943, dhe pse nuk ishte projektuar të ftohej edhe në Konferencën e ardhshme të 44 kombeve, që do të mbahej më 1-15 korrik 1944, në Breton Woods të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në memorandumun që Sekretari Amerikan i Shtetit Cordell Hull, do ti dërgonte Presidentit më 27 maj

²⁷ *FRUS*, Diplomatic Papers, 1944, Volume I, Washington, 1966, pp. 885-888.

²⁸ *The 1992 Almanac*, Boston: 1992, pp. 287-289.

²⁹ *NARA*, RG 226, Alexander Kirk to Secretary of State, April 18, 1944; Po aty, Çikago, 6 qershor 1944.

1944 për këtë problem, do të shprehej³⁰: “Që nga pushtimi italian i Shqipërisë nuk ka pasur jashtë Shqipërisë ndonjë autoritet të mjaftueshëm që të paraqesë ndonjë pretendim substancial, për të prezantuar forcat e rezistencës brenda vendit, ose që të unifikojë grupet shqiptare jashtë vendit. Pas pushtimit italian, qeveria e mbretit Zog u shpërbë, Zogu përfundimisht siguroi leje qëndrimi në Angli, me cilësinë e një personi të shquar privat. Qeveria amerikane nuk u dha kurrë fund marrëdhënieve të saj me mbretin Zog, por ministri ynë në Tiranë u udhëzua që të largohej nga Shqipëria dhe legata shqiptare në Uashington u mbyll në pranverën e vonë të vitit 1939. Pas kësaj së paku, qeveria e fundit duhet të konsiderohet si e pezulluar dhe se grindjet përçarëse i penguan mërgimtarët e tjerë nga formimi i ndonjë grupi me karakter përfaqësues. Për fat të keq, ndërmyjet patriotëve brenda vendit ka një mungesë të ngjashme uniteti. Si rrjedhojë, tani nuk ka ndonjë, që të ftohet në ndonjë konferencë ndërkombëtare, pa paragjykuar institucionet e ardhshme politike të vendit”. Dokumentet amerikane provojnë se gjatë vitit 1944, u shpeshtuan kërkesat jashtë Shqipërisë për njohjen e qeverisë së Zogut, ndërsa brenda vendit autoriteti i tij ishte në rënie. Qeveria amerikane i përmbahej politikës së mospërfshirjes në punët e brendshme të vendeve të tjerë, dhe zgjidhjes së problemeve të mëdha në periudhën e pasluftës. Sidoqoftë, qeveria amerikane nuk ishte dakord me vendimin e Kongresit të Përmetit, i cili e ndalonte kthimin e mbretit Zog në Shqipëri, ndërsa për sa i përkiste formës së qeverisjes, ai do të ishte një problem që do të zgjidhej pas luftës. Karta e Zogut nuk u hodh poshtë nga qeveria amerikane por u ruajt si kartë rezervë, e cila mund të aktivizohej në të ardhmen, pasi nuk besohej tek shanset qeverisëse të komunistëve shqiptarë. Ndërkaq qeveria amerikane si edhe ajo britanike kishin njohur qeveritë jugosllave dhe greke në emigracion, të cilat nënshkruan dokumente të rëndësishme për fatin e vendeve që ato përfaqësonin, siç ishte Karta e Atlantikut, Deklarata e Kombeve të Bashkuara, Marrëveshja për krijimin e Kombeve të Bashkuara, e firmosur nga përfaqësues të 39 kombeve, por jo nga Shqipëria etj. Ndërsa Shqipëria mbeti e pa përfaqësuar në evenimentet e mëdha të LDB, duke dëmtuar kështu imazhin e saj ndërkombëtar dhe sidomos interesat kombëtare të popullit shqiptar. Imazhi ndërkombëtar i Shqipërisë ishte i dobët, dhe mbeti i tillë edhe gjatë qeverisjes komuniste. Përçarjet brenda dhe jashtë vendit, shpifjet dhe animimet për njëri tjetrin të adresuara qeverive dhe drejtuesve të lartë të vendeve aleate, ishin një metodë e preferuar për jo pak shqiptarë, duke përfshirë këtu edhe disa nga figurat më të shquara të kohës.

Kërkesës së FNÇL për ta njohur zyrtarisht qeverinë e dalë nga *Kongresi i Përmetit*, qeveria amerikane do ti jepte përgjigje negative sepse, sipas saj ajo nuk ishte qeveri që përfaqësonte gjithë shqiptarët as në linjën vertikale dhe as

³⁰ FRUS, Diplomatic Papers 1944, Volume III, *The British Commonwealth and Europe*, Washington, 1965, pp. 271-272.

atë horizontale. Autoriteti i saj shtrihej kryesisht në zonat e jugut dhe të Shqipërisë së Mesme. Amerikanët u ruheshin prononcimeve dhe mbështetjes së një grupi rival në vend, sepse kjo do të influenconte mbi të ardhmen politike të vendit³¹. Politika amerikane bazohej në konsiderata të natyrës ushtarake dhe këtij kriteri iu përmbajt pothuajse deri në fund të luftës. Amerikanët u njohën me direktivën e re të Ministrisë së Jashtme të Britanisë së Madhe në lidhje me Shqipërinë në shtator 1944. Sipas saj shtete si Shqipëria, Bullgaria dhe Jugosllavia po shtyheshin drejt orbitës sovjetike. Qeveritë e tyre në kundërshtim me interesat britanike simpatizonin Rusinë Sovjetike. Në këto rrethana propozohej që të tërhiqej mbështetja për Abaz Kupin dhe nacionalistët dhe të ftohej Enver Hoxha për bisedime me gjeneralin Wilson në Bari³². Hoxha do të ftohej me qëllim që të zbuste qëndrimin ndaj elementëve nacionalistë dhe të zgjeronte bazën e koalicionit të tij. Por sërish shfaqej dyshimi se qeveria mund të mos ishte e aftë dhe për këtë qëllim mbahej rezervë figura e Zogut. Deri në shtator 1944, amerikanët mbështesnin alternativën e bashkimit të gjithë grupeve shqiptare të rezistencës për çlirimin e vendit të tyre, duke ndjekur në përgjithësi vijën e propozuar nga britanikët. Por amerikanët në Shqipëri sipas këshillave të Sekretarit të Shtetit nuk duhej të lartësonin britanikët duke shfrytëzuar prestigjin e amerikanëve në Shqipëri.

Duket se amerikanët e kishin shtuar interesin e tyre për Ballkanin në verë-vjeshtë të vitit 1944, dhe kërkonin të zbatonin idetë e tyre, pa qenë thjesht vëzhgues të ngjarjeve³³. Me gjithë këmbënguljen e përfaqësuesve të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇL, që morën pjesë në takimin e Barit në korrik-gusht të vitit 1944, as amerikanët dhe as britanikët nuk e njohën atë. Thjesht aleatët në këtë periudhë njohën Shtabin e Përgjithshëm të UNÇL, si një organizëm ushtarak dhe jo politik dhe premtuan ta ndihmonin atë për të rritur efikasitetin luftarak të saj. Këtij qëllimi i shërbeu emërimi i Alan Palmer si oficeri kryesor i Komandës Aleate pranë Shtabit të Përgjithshëm të UNÇL dhe dërgimi në Bari i Kadri Hoxhës si përfaqësues ushtarak i Shtabit të Përgjithshëm të UNÇL. Sidoqoftë, aleatët në këtë periudhë e shtuan numrin e personelit të misioneve të tyre, pranë Shtabit të Përgjithshëm dhe në njësitë e mëdha ushtarake, si divizionet etj. Edhe amerikanët e shtuan numrin e personelit të OSS në vend, dhe ngarkuan toger Stefanin si oficer ndërlidhës dhe zbulues në Shqipërinë Jugore dhe Qendrore pranë Shtabit të Përgjithshëm. Marrëveshja e firmosur në Bari në gusht 1944, e njohu ushtrinë NÇL si të vetmen forcë të organizuar që luftonte me gjermanët. Përveç karakterit të kufizuar përfaqësues të qeverisë së

³¹ *Po aty*, f. 277. Kirk për Sekretarin e Shtetit, 16 shtator 1944.

³² *Po aty*, f. 281. Aleksandër Kirk (Këshilltar Politik i SHBA në Shtabin e Forcave Aleate) për Sekretarin e Shtetit, më 8 tetor 1944.

³³ *Po aty*, f. 275-276. Njoftim i Sekretarit të Shtetit për konsullin e përgjithshëm të SHBA në Napoli (Brandt), më 20 korrik 1944.

dalë nga Kongresi i Përmetit apo mbledhja e Beratit, qeveria amerikane, si edhe në rastin e Zogut, nuk donte të paragjykonte zhvillimet e ardhshme politike të vendit³⁴.

Në gusht – shtator 1944, me ardhjen në Shqipëri të misioneve ushtarake të Bashkimit Sovjetik dhe të Jugosllavisë, u forcuan ngjyrimet politike të udhëheqjes së lëvizjes çlirimtare të së majtës shqiptare. Misioni sovjetik, ndonëse nuk pati ndonjë angazhim konkret ushtarak në vend, por thjesht mbeti një mision informativ, u prit shumë më mirë se misionet aleate të demokracive perëndimore. Sidoqoftë, duke njohur realitetin e fundit të luftës dhe shanset e ardhjes në pushtet të qeverisë së FNÇL, amerikanët ngarkuan më 15 tetor 1944, kapiten Stefanin, që t'i bënte të ditur Hoxhës se, qeveria amerikane pas largimit të gjermanëve, do të sillte në Shqipëri një mision tjetër, i cili do të studionte gjendjen në vend, dhe do të vendoste në lidhje për hapat e tjerë për njohjen³⁵. Duhet të përmendim se, Enver Hoxha ishte njohur që më parë për idenë e ardhjes së një misioni tjetër të SHBA në Shqipëri, përmes Misionit të OSS në Shqipëri. Por ai i kishte bërë të ditur toger Stefanit se ai dhe shtabi i tij nuk dëshironin që në përbërje të tij të kishte qytetarë amerikanë të lindur në Shqipëri, por vetëm nga ata që kishin lindur në Amerikë. Duke komentuar opinionin e Hoxhës, Stefani do të shprehej: “duket e pamundur për një të lindur në Shqipëri, që të mos ketë ca zgjedhje politike”³⁶. Për këtë hap, SHBA ishin këshilluar me qeverinë e Britanisë së Madhe dhe atë të BRSS.

Në rrethanat e mbarimit të luftës, dhe të ardhmes politike të Shqipërisë, Sektori i Çështjeve të Evropës Juglindore pranë Departamentit të Shtetit paraqiti më 7 tetor 1944, një studim për problemin e njohje së qeverisë shqiptare.³⁷ Studimi fillon me dilemën që e ka shqetësuar Departamentin e Shteti muajt e fundit: nëse duhet të njohë qeverinë e Frontit NÇL, për Komitetin Kombëtar apo për qeverinë në emigracion (kupto: qeverinë e Zogut, H.K.). Edhe njëherë theksohet se politika amerikane ka pasur si qëllim të nxisë unitetin brenda vendit dhe të zbatojë parimet e Kartës së Atlantikut. Çështja e njohjes së Qeverisë së FNÇL i është rekomanduar qeverisë amerikane nga disa drejtues të OSS në Shqipëri, nga “Vatra” dhe “Shqipëria e Lirë” në SHBA, si dhe nga kongresi i Përmetit. Në Shqipëri janë misionet sovjetike, jugosllave dhe britanike, të cilat i kanë dhënë mbështetje së fundi vetëm lëvizjes NÇL. Në këto rrethana studimi përmend 16 argumente kundër njohjes dhe 20 pro saj. Ndër argumentet kundër njohjes do të përmendim se SHBA deri tani kanë

³⁴ NARA, Hull to Murphy, July 17 1944; Murphy to Secretary of State, August 12, 1944.

³⁵ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSh), Fondi 41, viti 1944, dos. 146, 15 tetor 1944.

³⁶ NARA, RG 226, September 14, 1944.

³⁷ *Po aty*, M 1211, Roll 16, Problemi i njohjes shqiptare, 7 tetor 1944.

ruajtur parimin e mospërfshirjes në punët e brendshme të shqiptarëve; se njohja e qeverisë së Frontit do të thoshte të ndërhyje në punët e brendshme, se FNÇL është në thelb një organizatë komuniste, se përfaqëson pjesërisht shqiptarët, se ai përfshin pak figura të shquara në udhëheqje, se do të shkaktonte çarje më të thella politike në të gjithë vendin, se njohja e qeverisë së Hoxhës do të shkatërronte plotësisht çdo shpresë për rikthimin e Zogut, se Hoxha përfaqësonte një klikë qeverisëse e cila nuk ishte e besueshme për amerikanët dhe britanikët etj. Por kishte edhe mjaft argumente në favor të njohjes, ndër të cilat do të përmendnim: se FNÇ po i bënte rezistencë efektive gjermanëve dhe se e meritonte njëfarë njohjeje, se elementët që s'kanë marrë pjesë në rezistencë nuk kanë të drejta morale të gëzojnë besimin e aleatëve, se aleatët kanë mbështetur lëvizjen NÇL dhe duhet të mbështesin edhe qeverinë e dalë prej saj, se mosnjohja do ta shtonte influencën e Ruisë, se kjo e fundit nuk mund t'i japë ndihma vendit sikurse aleatët perëndimorë, se Presidenti dhe Sekretari i Shtetit kanë shpallur se fashizmi duhet rrëzuar kudo qoftë ai, se mosnjohja mund të provokojë luftën civile brenda vendit, se Kupi dhe Balli Kombëtar dhe shumë figura të mirënjohura ishin të molepsura me bashkëpunim, se nuk ekzistonin grupe të tjera patriotike dhe jo bashkëpunuese në vend etj. Në fund studimi përfundonte se njohja mund të ofrohej në formën e njohjes së një qeverie të zonave të çliruara të Shqipërisë, njohje të autoritetit të përkohshëm në zonat nën kontroll të lëvizjes NÇL, si një qeveri e përkohshme e gjithë vendit dhe së fundi si një grup rezistence që kontrollonte zona të caktuara të vendit. Pra Departamenti i Shtetit nuk arriti as ta njoh qeverinë e FNÇL, por as ta refuzonte atë. Në bashkëpunim me britanikët dhe sovjetikët, amerikanët vendosën të dërgonin në Shqipëri një Mision Civil, por jo zyrtar, i cili do të studionte gjendjen në Shqipëri dhe do ti raportonte qeverisë amerikane për hapat në lidhje me njohjen e saj. Ajo kërkoi gjithashtu të përmbusheshin disa kushte që lidheshin me karakterin jo fashist të qeverisë, se ajo kishte vendosur autoritetin e saj në vend, se përfaqësonte interesin e popullit dhe se ishte e përgatitur të përmbushë detyrimet ndërkombëtare. Ndihmës Sekretari Amerikan i Shtetit më 15 nëntor 1944 në një konferencë shtypi do të deklaronte: “kjo qeveri nuk ka njohur ndonjë person apo grup si autoritet të shqiptarëve, megjithëse ne kemi theksuar në mënyrë të përsëritur miqësinë tonë tradicionale për popullin shqiptar, dhe dëshirën tonë për arritjen e pavarësisë së plotë të tij”.³⁸

Më 25 nëntor DSH i paraqiti presidentit Rusvelt propozim për dërgimin e Misionit në Shqipëri, i cili e miratoi atë, dhe pas tij u ngarkua Jacobs të krijonte Misionin Civil, i cili u vendos në Shqipëri më 9 maj 1945. Ndërkohë duke ju përmbajtur kësaj politike qeveria amerikane nuk e pranoi propozimin e Qeverisë së Beratit për të dërguar në Uashington një përfaqësues ushtarak dhe

³⁸ NARA, Statement by Acting Secretary of State, November 15, 1944.

një person tjetër që do të merrej me problemet dhe nevojat financiare të Shqipërisë së pasluftës.

S u m m a r y

THE U.S.A. POLICY TOWARD ALBANIA DURING
THE SECOND WORLD WAR
1943-1944

This article on the U.S. attitude towards the Albanian resistance during 1943-1944, deals with a previously unconsidered case by the Albanian historiography and almost not at all by the foreign one. The researchers have focused primarily on the British reports and of their missions in Albania during the war period by leaving almost unmentioned the U.S. position and of the OSS Mission (Office of Strategic Services) in Albania during 1943-1944. The aforementioned article is based mainly on unpublished archival documentation or partly published, founded on Albanian and American archives, as well as in several foreign studies.

During 1939, U.S.A. unlike Great Britain, France and the neighbouring countries of Albanian, it condemned the Italian occupation of Albania, an action, which was followed by the withdrawal of its diplomatic representation in Albania.

Although, Albania did not constitute a priority for the U.S.A. policy during World War II and was not included in the list of countries that benefit from the program "Land Lease", it sent to Albania an OSS mission. This mission helped the Albanian resistance and informed the State Department on the political and military forces in the country. In the activity of the OSS mission in Albania until the end of the war dominated the military interests against those political. The U.S.A. government during the World War II did not recognize Zog's government in exile or the governments of the National-Liberation Front that emerged from the Congress of Përmet and Berat Meeting. In addition, it did not legally considered Albania as a nation allied or associated allied. The U.S.A. stance toward Albania during 1943-1944 is based on documents of the high levels of the U.S. policy such as the State Department, the President, etc., but also on the documents originating from the ground as was the case for the documents forwarded by the OSS Mission in Albania, Office of Bari in Italy etc.

